



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA –REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Në çështjen juridike të :

AC-I-15-0228-A0002

A0001 Z.B. Lipjan.

Ankuesja

Kundër:

E paditura/Ankuesja

A0002 Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rr. "Agim Ramamdani", nr. 23, Prishtinë.

Kundër:

Ankuesi në shkallë të parë

C-0002- R.V. Lipjan.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Ilmi Bajrami, gjyqtar kryesues, Hajrie Shala dhe Sabri Halili, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e ankuesve, të parashtruar kundër Aktgjykimit të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së, C-II-13-0123 të datës 07 tetor 2015 në seancën vendimmarrëse të mbajtur më 12/09/2019 lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

1. Ankesa e ankueses, A0001 refuzohet si e pa bazuar. Vërtetohet pika – III- e dispozitivit të Aktgjykimi i Kolegjit të Specializuar të DHPGJS, C-II-13-0123 të datës 07 tetor 2015.

2. Ankesa e ankueses A0002,(AKP-së) është e bazuar dhe anulohet pika – I-e dispozitivit të Aktgjykimit Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së, C-II-13-0123 të datës 07 tetor 2015, sa i përket ankuesit C-0002- R.V., i njëjti hiqet nga lista e punëtorëve të kualifikuar, përfitues të 20 % nga procesi i privatizimit të NSH-së "T" në Lipjan.

3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.

Rrethanat procedurale dhe gjendja faktike

Ndërmarrja Shoqërore NSH "T" në Lipjan është privatizuar nga e paditura (tani e tutje AKP) me datë 19 Nëntor 2011.

Lista përfundimtare e punëtorëve me të drejta legjitime ishte publikuar në mjetet e informimit publik në gjuhën shqipe gazetën "Kosova Sot", dhe "Koha Ditore", dhe në gjuhën serbe gazeta " Vijesti" me datë 18,19, dhe 20 Prill 2013.

Afati i fundit për paraqitjen e ankesave në DHPGJS kundër listës përfundimtare të punëtorëve ishte 11 Maj 2013.

Ndaj listës përfundimtare të AKP-së për punëtorët e kualifikuar, përfitues të 20 % të ardhurave nga privatizimi i NSH "T" në Lipjan, në DHPGJS kanë parashtruar ankesë: S.S. (C0001), R.V. (C-0002), R.S.(C-0003), dhe Z.B. (C-0004).

Më 07 Tetor 2015 Kolegji i Specializuar i Dhomës së Posaçme nxori Aktgjykimin **C-II-13-0123** me të cilin:

- I- Ankesa e ankuesit R.V. (C-0002), nën pikën–I- të këtij dispozitivi, aprovohet si e bazuar mbi bazën se i njëjti ka qenë në marrëdhënie pune deri në privatizimin e NSH-së.

-II- REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e S.S. (C-0001) me arsyetim se i njëjti nuk ka dëshmuar se ishte punëtor i NSH-së deri në ditën e privatizimit.

-III- Hudhen posht si të PA PRANUESHME ankesat e ankuesve:

- R.S.(C-0003), dhe Z.B. (C-0004), me arsyetim se të njëjtit kanë parashtruar ankesë pas afatit kohor.

Ndaj këtij Aktgjykimi, janë paraqitur dy ankesa si në vijim:

Më datë 22.10.2015, Ankuesja A0001 Z.B. (në emër të bashkëshortit), të saj të ndjerë Sh.B., i ka parashtruar ankesë kundër pikës -III- të dispozitivit të Aktgjykimit, C-II-13-0123 të datës 07 tetor 2015, (më tutje Aktgjykimi i ankimuar) për shkak të siç thuhet, shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe shkeljes të së drejtës materiale, dhe i propozon Kolegjit të Apelit i Dhomës së Posaçme ta aprovojë ankesën si të bazuar, dhe anulon piken -III- të Aktgjykimit të ankimuar.

Ankuesja pohon se janë bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, sepse Gjykata në kuptim të nenit 8 të LPK-së nuk i ka vlerësuar drejtë, dhe nuk qëndrojnë pretendimet e theksuara në arsyetim të Aktgjykimit të kundërshtuar se kinse ne e kemi humbur afatin e ankesës, sepse nga fleterekomandaja e dt. 17.01.2013, shihet se ankesa është ushtruar me kohë. Po ashtu ndaj bashkëshortit tim janë bërë diskriminime të paparapara, nga ana e kompetenteve të të paditurës dhe nga Sindikata e përgjithshme kur nuk e kanë bërë rangimin e bashkëshortit tim në listë.

AKP-ja nuk ka parashtruar përgjigje .

Me datë 29.10.2015 Ankuesja A0002 Agjencia Kosovare e Privatizimit ka parashtruar ankesë kundër pikës -I- të dispozitivit të Aktgjykimit të ankimuar, për shkak të siç thuhet, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale dhe i propozon Kolegjit të Apelit i Dhomës së Posaçme ta aprovojë ankesën si të bazuar, dhe anulon piken -I- të Aktgjykimit të ankimuar. Sipas AKP-së, Ankuesi në bazë të Aktvendimit të plotfuqishëm ishte pensionuar për shkak të arritjes së moshës për pension. Gjithashtu Kolegji i Specializuar gabimisht ka interpretuar dispozitën ligjore kur nga i padituri kërkon të dëshmojë mos ekzistimin e diskriminimit të pohuar nga ankuesi pa asnjë fakt relevant në bazë të cilit do të ishte vërtetuar diskriminimi dhe pa ofruar nga ankuesi fakte dhe prova nga të cilat mund të parashikohet

diskriminimi direkt apo indirekt në pajtim me nenin 8.1 i ligjit kundër diskriminimit.

Andaj si pasojë e vërtetimit të gabuar dhe arbitrar të gjendjes faktike, pason edhe aplikimi i gabuar i të drejtës materiale, respektivisht deri te aplikimi i të drejtave të cilat nuk i takojnë ankuesve, e në të cilat bazohet arsyetimi i aktgjykimit të atakuar.

Ankesa e ankuesit i është dorëzuar palës kundërshtare.

Përgjigje në ankesë ka parashtruar R.V., (C-0002), i cili ankesën e AKP-së e kundërshton në tërësi si të pa bazuar.

Arsyetimi ligjor

Ankesa A0001 refuzohet si e pa bazuar. Ndërsa ankesa e ankueses A0002 (AKP-së) aprovohet si e bazuar .

Në bazë të nenit 69.1 të Shtojcës së Ligjit të Republikës së Kosovës nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet lidhur me Agjencinë Kosovare të Privatizimit ,Kolegji i Apelit vendos që të heq dorë nga pjesa gojore e procedurës.

Ankuesja A0001 Z.B. (në emër të bashkëshortit), të saj të ndjerë Sh.B., ka parashtruar ankesë kundër pikës -III- të dispozitivit të Aktgjykimit të ankimuar , për shkak të siç thuhet, shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe shkeljes të së drejtës materiale, dhe i propozon Kolegjit të Apelit i Dhomës së Posaçme ta aprovjë ankesën si te bazuar, dhe anulon piken -III- te Aktgjykimit të ankimuar.

Ankuesja pohon se janë bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, sepse Gjykata në kuptim të nenit 8 të LPK-së nuk i ka vlerësuar drejtë, dhe nuk qëndrojnë pretendimet e theksuara në arsyetim të Aktgjykimit të kundërshtuar se kinse ne e kemi humbur afatin e ankesës, sepse nga fleterekomandëja e dt. 17.01.2013, shihet se ankesa është ushtruar me kohë.

Po ashtu ndaj bashkëshortit tim janë bërë diskriminime të paparapara, nga ana e kompetenteve të të paditurës, dhe nga Sindikata e përgjithshme kur nuk e kanë bërë rangimin e bashkëshortit tim në listë.

Ankuesja ka prezantuar Librezën e Punës së bashkëshortit të saj të ndjerë ku shihet se ai ka punuar ne NSH nga data 06.08.1980 e deri me datën 30.05.1986, dhe nga data 01.09.1986 dhe nuk është mbyllur si dhe një flete-rekomande e dt. 17.01.2013, dërguar AKP-së.

AKP-ja nuk kishte parashtruar asnjë përgjigje ndaj ankesës.

Kolegji i Apelit vlerëson se Kolegji i Specializuar saktë ka vendosur kur e ka hedhur poshtë si të papranueshme ankesën e ankuesit C-0004, sepse ankuesja ka parashtruar ankesë jashtë afatit të paraparë ligjor. Afati i fundit për parashtrimin e ankesës ishte data 11 Maj 2013, ndërsa ankuesja ka parashtruar ankesë pas afatit ligjor gjegjësisht më 21/02/2014. Fletë rekomandeja e cila mban datën 17.01.2013, e parashtruar tani para Kolegjit të Apelit vërteton një dërgesë pa emërtim, dërguar AKP-së , para publikimit të listës përfundimtare.

Në provë të tillë Kolegji i Apelit nuk mund të konsideroj si valide jo vetëm për arsye se njëjta nuk është parashtruar para Kolegjit të Specializuar por edhe për arsye s nuk përmban asnjë referencë për llojin e dërgesës, kohën e dërguar e cila nuk përputhet me afatin për ankesë ndaj listës së përkohshme dhe listës përfundimtar. E njëjta nuk prezanton kurrfarë fakti apo dëshmi për të dëshmuar arsyet e vonesës për Kolegjin e Specializuar, e as para Kolegjit te Apelit nuk afron ndonjë fakt apo dëshmi me te cilën sqaron arsyet e vonesës së saj.

Në baze të nenit 10.6 (a) të Rregullores se UNMIK-ut 2003/13, Kolegji i Apelit vlerëson se ankesa e ankuesit me të drejtë është hedhur poshtë si e papranueshme, pasi që ajo ishte paraqitur jashtë afatit ligjor.

Prandaj Ankesa e A0001, refuzohet si e pa bazuar dhe vërtetohet pika -III- e dispozitivit të Aktgjykimit ankimuar .

Ankesa e të paditurës, AKP-së A0002 dhe Vlerësimet e Kolegjit të Apelit.

E paditura e konteston Aktgjykimin e ankimuar, pikën -I- të dispozitivit për ankuesin, ankesa e të cilit është aprovuar si e bazuar dhe ky ankues është përfshirë në listën përfundimtare për të drejtën legjitime për 20 %.

E paditura me ankesë e kundërshton-I- të diapozitivit të Aktgjykimit të ankimuar, pretendon se Aktgjykimi i ankimuar është jo konsistente i pa argumentuar në bazë të ligjit, nuk përmban fakte qenësore dhe në mënyrë arbitrare e interpreton ligjin.

AKP-ja konstaton se në rastin konkret sipas të dhënave në librezën e punës shihet se ankuesi R.V. (C0002) të cilit ju ka aprovuar ankesa ka lindur me datën 10.01.1946 dhe në datën e privatizimit ka arritur moshën e pensionimit të pleqërisë, dhe nuk i plotëson kriteret në bazë të nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 (me ndryshime) dhe dispozitave tjera ligjore në fuqi e rregullojnë këtë qështje administrative.

Gjithashtu për rastin konkret nuk ka asnjë element të diskriminimit të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në bazë të nenit 8 par.8.1 të ligjit kundër Diskriminimit nr.2004/3.

Ankuesi **R.V. (C0002)**, me datë 10.05.2013 ka parashtruar ankesë në Dhomën e Posaçme kundër- AKP-së duke kërkuar përfshirjen në listën e punëtorëve me të drejta legjitime për të marrë 20% nga një pjesë e të ardhurave nga privatizimi i NSH "T" në Lipjan.

Ai ka deklaruar se ka punuar në NSH nga 21 qershori 1986 gjer më 1990 kur marrëdhënia e tij e punës është ndërprerë në mënyrë diskriminuese , është larguar me dhunë nga NSH-ja për shkak të masave të dhunshme serbe. Ai ka theksuar se iu është kthyer marrëdhënia e punës sërish nga ana e Gjykatës Supreme të Serbisë me nr.2297/96 të datës 27.05.1997 dhe ka punuar deri në qershor të vitit 1999. NSH-ja nuk ka qenë funksionale pas vitit 1999 por në vitin 2000 është komercializuar dhe menaxhuar nga një kompani private "D".

Ai thekson se ka punuar pas privatizimit të NSH-së për mirëmbajtjen e përkujdesjen e dokumentacioneve personale të punëtorëve dhe i ka ofruar gjykatës kopjen e listës së punëtorëve të regjistruar gjatë tërheqjes së dokumenteve personale-dosjet nga NSH-ja gjatë privatizimit. Ankuesi ka pohuar se ka qenë i diskriminuar për shkak të trajtimit jo të barabartë me punonjësit tjerë ngase nuk e ka arritur moshën e pensionimit kur ndërmarrja ka qenë

funkionale në vitin 2010. Ai po ashtu ka pretenduar se ka vazhduar të punojë në NSH gjatë dhe pas privatizimit edhe pse e ka arritur moshën e pensionimit. Si dëshmi ankuesi ka bashkangjitur kopjen e librezës së punës e cila është ende e hapur, kopjen e aktvendimit të datës 01 korrik 1986, kopjen e aktvendimit për pushim vjetor të datës 07.07.1987 dhe 22.08.1988, kontratën e punës të datës 11.12.2001, kopjen e vërtetimit 19.12.2012, kopjen e Aktvendimit të plotfuqishëm të Gjykatës Supreme të Serbisë Re.br.2297/96 të datës 27.05.1997, kopjen e listës së punonjësve të datës 13.08.2012 dhe kopjen e vërtetimit të punësimit të datës 19.12.2012.

Kolegji i Apelit konsideron se arsyet e dhëna nga Kolegji i Specializuar për aprovimin e ankesës nuk janë të sakta, sepse i njëjti nuk ka mund të jetë në listën e pagave në kohën e privatizimit pasi kishte arritur i moshën 65 vjeçare.

Ankuesi nuk ka arrite me asnjë provë të vërtetohet të kundërtën e thënë në arsyetimin e Komisionit vlerësues të AKP-së sipas të cilit kërkesa për përfshirjen e tij në listën e përfituesve të 20 % , refuzohet për arsye se i njëjti më datë 10/01/2011 kishte arritur moshën e pensionimit ndërsa privatizimi ka ndodhe më 19/11/2011 sikundër nuk ka parashtruar prova tjera as me ankesë ndaj listës përfundimtare si dhe në përgjigjen ndaj ankesës së AKP-së ndaj Aktgjyqimit të ankimuar.

Në bazë të nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13. Sipas këtij neni, punëtori konsiderohet si legjitim nëse është i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes në pronësi shoqërore në kohën e privatizimit dhe nëse konstatohet se ka qenë në listën e pagave të ndërmarrjes për jo më pak se tri (3) vite.

Prandaj Kriteret ligjore në bazë të nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 e ndryshuar me Rregulloren 2004/45 nuk janë plotësuar.

Andaj ankesa e AKP-së lidhur me këtë punëtor aprovohet si e bazuar, dhe rrjedhimisht pika -I- e dispozitivit të Aktgjyqimit ankimor lidhur me këtë punëtor të lartcekur si më lartë duhet të ndryshohet, i njëjti të hiqet nga lista e përfituesve të 20 % nga privatizimi i NSH-së.

Me sa u tha më sipër e në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së është vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Taksat gjyqësore:

Nuk caktohen taksat gjyqësore në procedurat lidhur me listën e punëtorëve.

Lëshuar nga Kolegji i Ankesave i DHPGJS-së, më 12/09/2019

Ilmi Bajrami, Gjyqtar Kryesues _____

URDHËR PËR ZYREN E REGJISTRIM

Luteni ta dërgoni këtë Aktgjykim tek:

- Ankuesit
-
- Ankuesit në shkallë të parë

- Tek e paditura/ankuesja,

- Gjyqtarit të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së në lëndën C-II-13-0123 të datës 07 Tetor 2015.

Ilmi Bajrami Kryesuesi i Kolegjit të Apelit